

Sjellim kontekstin global në zhvillimin e strategjisë së turizmit për Prizrenin

FAQE 2

Më shumë gra fermere përfshihen në kultivimin e bimëve mjekësore aromatike

FAQE 2

Qasje në mundësi për përmirësim të jetesës

FAQE 3

2018  
DHJETOR

# Buletini.

KRIJIMI I VENDEVE  
TË PUNËS DHE  
MUNDËSIVE TË  
TREGUT



## Pak fjalë për vitin 2018!

Edhe një tjetër vit që kaloi kaq shpejt! Teksa i afrohem fundit të vitit 2018, le të shohim se çfarë ndodhi gjatë vitit të parë të implementimit të Fazës 2 të PPSE-së (nëntor 2017- nëntor 2021).

Të dhënat na tregojnë se **795** persona kanë përfituar nga mundësitë për punësim. Prej tyre, **44%** janë gra dhe mbi **20%** nga minoritetet. Këto vende pune të reja në sektorët e Ushqimit dhe Përbërësve Natyralë dhe Turizmit përfshijnë edhe vende pune sezonale. Përfitimet e punësimit për këtë vit, që nënkuptojnë sa para kanë fituar këta persona nga këto vende pune që u krijuan përlogariten në rreth **CHF1,511,000**.

Rreth **95** ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NMV) kanë siguruar **CHF 745,000** si të ardhura shtesë neto. Kjo nënkupton përfitime shtesë të gjeneruara nga NMV-të që në mënyrë direkte ose indirekte kanë përfituar nga mbështetja e PPSE-së përmes intervenimeve të targetuara. Po ashtu, **234** ferma kanë pranuar

mbështetje direkt nga projekti me synim rritjen e prodhimit parësor.

Sektori i Ushqimit dhe Përbërësve Natyralë vazhdoi të promovojë modelin e bujqësisë së kontraktuar, që është vënë në zbatim në 6 rajone të reja me 9 partnerë të rinj, me synim rritjen e prodhimit parësor të perimeve dhe bimëve mjekësore aromatike. Ndryshime të tjera të rëndësishme që ndodhën këto muaj ishin programet për prodhimin e specializuar të fidanëve dhe certifikimit për promovim të eksportit, krahas mbështetjes për pjesëmarrje dhe ekspozim në panaire dhe organizimin e misioneve të shitjes. Lexoni më shumë në faqet 3 dhe 4.

Aktivitetet e sektorit të Turizmit për zhvillimin e produkteve të reja dhe strategjive të posaçme u fokusuan në rajonet e Prizrenit dhe Prishtinës, të plotësuar me aktivitete që synojnë të përmirësojnë organizimin e sektorit në shkallë vendi dhe lokale. Aktivitete për promovimin ndërkombëtar, si

udhëtime familjarizuese dhe të shtypit që synojnë në veçanti tregun aziatik dhe përgatitjet për panaire u intensifikuan edhe më tej. Lexoni më shumë në faqen 3.

Fondi i Mundësive, si pjesë e rëndësishme për të dy sektorët, ka mbështetur projekte të bashkëinvestimit për të promovuar rritjen e qëndrueshme të zinxhirit të vlerave. Fondi për Gjithëpërfshirje Sociale, një mekanizëm i ri që solli Faza II ka mbështetur aktivitete që nxisin barazinë dhe gjithëpërfshirjen e grupeve shoqërore të marginalizuara. Lexoni më shumë në faqen 2.

Kjo pasqyrë është rezultat direkt i angazhimit të PPSE-së në aktivitete që kanë potencial të përshkallëzohen dhe zgjerohen. Fjalët kyçe që përshkruajnë punën tonë gjatë këtij viti janë “zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe përmirësimi i atyre ekzistuese”.

Shihemi në vitin 2019!

# INFORMATA KRYESORE NGA PUNA JONË

## Sjellim kontekstin global në zhvillimin e strategjisë së turizmit për Prizrenin

■ Enes Toska nga Prizreni është ciceron qyteti i sapotrajnuar për qytetin e tij të lindjes dhe ai ka shumë informata për diversitetin kulturor, bukuritë e fshehura dhe ku të gjenden ushqimet e shijshme vendase. Enesi ishte një prej trembëdhjetë të rinjve nga Prizreni, Prishtina dhe Gjakova që ndoqën programin e trajnimit një mujor për ciceronë qyteti nga Gears Up Solutions. Me këto shkathtësi të reja, ata plotësojnë mungesën për njerëz në këtë profesion, që është një nga hallkat kryesore në zinxhirin e zhvillimit të turizmit në Kosovë.

Së shpejti, paragliding do të ofrohet në Prizren si produkt. Dy pjesëtarë të Aeroklubit Shkaba në Prizren po e shndërrojnë pasionin e tyre sportiv në aktivitet që gjeneron të ardhura. Marrëveshja tripalëshe ndërmjet Aeroklubit Shkaba, Komunës së Prizrenit dhe PPSE-së mbështet zhvillimin dhe komercializimin e paragliding si produkt turistik në këtë zonë. Pritet që të krijojë rreth 7 vende pune të reja për pilotë dhe ta bëjë Prizrenin destinacion më atraktiv.

Aktiviteti me kajake, akomodim glamuroz dhe biciklizmi janë produkte të tjera të reja që po zhvillohen në Prizren në partneritet me Supercampers dhe pritet të krijojnë së paku pesë vende pune si fillim. Këta janë disa nga shembujt e bashkëpunimit ndërmjet PPSE-së dhe Komunës së Prizrenit që kanë filluar këtë vit për zhvillimin e strategjisë së turizmit të qytetit, që i kontribuon zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe rrit punësimin. Në tetor 2018, rreth 40 përfaqësues të hoteleve, organizatave kulturore, muzeve, ciceronëve, sporteve ekstreme, artizanëve dhe të tjerë nga Prizreni morën pjesë në një punëtori të fasilituar nga ekspertët e turizmit të Swisscontact për të diskutuar se si të shfrytëzohet sa më mirë potenciali i Prizrenit për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit.

“Do të kemi një plan për zhvillimin e turizmit dhe zgjidhje për të rritur kapacitetet turistike që rrisin kohëzgjatjen e qëndrimit të turistëve si dhe numrin e tyre në qytetin tonë” tha Mytaher Haskuka, Kryetari i Komunës së Prizrenit.



## Produktet pyjore jodrusore të Kosovës më pranë tregjeve ndërkombëtare

■ Investimi në certifikim që dëshmon standardet e sigurisë së ushqimit për konsumatorët finalë, praktikata e mira bujqësore në kultivimin e produkteve pyjore jodrusore si dhe grumbullimi dhe ruajtja e bimëve nga natyra, shpaguehet. Tre kultivues të boronicës nga Kosova: Blue Pearls, Santefruit dhe BerryKode, kanë fituar certifikata Global GAP, që u mundësojnë të eksportojnë menjëherë në tregjet evropiane. “Kjo certifikatë është çelësi që hap derën për eksportin e boronocave të freskëve” thotë Kujtim Lepaja nga shoqata Mjedra e Kosovës që mundësoi procesin e certifikimit në bashkëpun-

im me PPSE. Nga ana tjetër, mundësia e takimeve ndërmjet kompanive në Kosovë dhe Evropë ka po aq rëndësi për sektorin. Në korrik, PPSE organizoi mision të shitjes në Zvicër për prodhuesit dhe përpunuesit e frutave të pyllit nga Kosova. Kompania zvicerane Bio-Partner e ktheu vizitën në tetor dhe arriti marrëveshje në parim me kompaninë Eurofruti, që do ta furnizojë këtë kompani zvicerane me fruta pylli të egra, ndërsa Bio-Partner do t'i sigurojë Eurofrutit mbështetje teknike për procesin e certifikimit Biosuisse, që është i nevojshëm për të eksportuar në tregun zviceran.

## MË SHUMË GRA FERHERE PËRFSHIHEN NË KULTIVIMIN E BIMËVE MJEKËSORE AROMATIKE

■ Më shumë gra fermere nga e gjithë Kosova po i kthehen kultivimit të bimëve mjekësore aromatike si mënyrë për të siguruar më shumë të ardhura. Në rajonin e Prishtinës, 99 Lule po e zgjeron rrjetin e grave të përfshira në kultivimin e BMA-ve dhe po shton llojet e kultivuara. Biofruti në zonën e Kaçanikut gjithashtu punon me një rrjet në zgjerim të grave fermere dhe e ka shitjen të sigurtë për gjithçka që grumbullojnë dhe kultivojnë: kompaninë Agroproduct në Istog.

Lexoni më shumë për rolin në rritje që luanë gratë në këtë sektor



# Qasje në mundësi për përmirësim të jetesës

Gjithëpërfshirja sociale ka të bëjë me ofrimin e qasjes në mundësi, punësim dhe mjete për grupet në nevojë dhe të marginalizuara që ata të përmbushin aspiratat e tyre për të përmirësuar kushtet e jetesës, duke punuar në mënyrë të dinjitetshme. Gjithëpërfshirja sociale strategjike përputhet me aktivitetet të tjera individuale për t'u shërbyer nevojave të komunitetit. Për PPSE, kjo nënkupton adresimin e nevojave për gjithëpërfshirje sociale duke punuar me sektorin publik dhe atë privat dhe me komunitetin e OJQ-ve dhe donatorëve, për të sjellë impaktin e synuar tek jetët individuale.

Ismet Selimoviq nga komuniteti rom në Graçanicë ka përfutur një presë që së paku do të trefishojë aktivitetin e tij të grumbullimit të shisheve plastike me të cilin nxjerr të ardhura. Ai është një nga tre romët që grumbullojnë plastikë dhe që kanë përfutur këto presa nga G-PLUS, një kompani që merret me grumbullimin dhe riciklimin e mbe-

turinave në Komunën e Graçanicës në bashkëpunim me PPSE në kuadër të përkrahjes për aktivitetet që gjenerojnë të ardhura për komunitetin rom në këtë zonë. Partneriteti me G-PLUS është pjesë e një projekti më të gjerë për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave në këtë komunë, nga njëra anë duke rritur qasjen për grumbulluesit individualë në mbeturina të grumbullueshme dhe të riciklueshme dhe nga ana tjetër duke rritur vetëdijësimin e banorëve për rëndësinë e klasifikimit të mbeturinave në nivel të shtëpive brenda territorit të Komunës së Graçanicës. Për këtë qëllim, autoritetet komunale kanë shpërndarë 354 kova për ndarje të mbeturinave në 177 shtëpi në këtë zonë, duke vijuar ndërkohë me aktivitete për rritjen e vetëdijësimin për rëndësinë e riciklimit dhe ndarjes së mbeturinave që në origjinë si mënyrë për të patur mjedis më të shëndetshëm për banorët dhe më tërheqës për turistë dhe vizitorë.



Ismet Selimoviq ka përfutur një presë që së paku do të trefishojë aktivitetin e tij të grumbullimit të shisheve plastike me të cilin nxjerr të ardhura.

## Në shërbim të komunitetit

■ Të përkujdesesh për më shumë se sa thjesht vetëm për atë që të rrethon dhe të besh çfarë mundesh për ata me më pak fat". Kështu e shpjegon Jehona Gjurgjeala, Drejtoreshë Ekzekutive e OJQ-së TOKA shtysën pas tranzicionit të kësaj OJQ-je në ndërmarrje sociale që planifikon të drejtojë një qendër rekreacioni dhe mikpritjeje në Kosovë. Kreativiteti në të mirë të të gjithë shoqërisë është mënyrë e sigurtë për të siguruar qëndrueshmërinë e gjenerimit të të ardhurave. PPSE mbështet TOKA-n për të bërë një studim fizibiliteti për projektin e tyre në shërbim të komunitetit.

## Arsimimi në teknologji rrit punësueshmërinë e grave

■ OJQ Qendra LEAP ka zhvilluar një studim për "Stereotipet gjinore dhe zgjedhjet për arsim në Kosovë", për t'i kontribuar perspektivës gjinore të burimeve në dispozicion në fushat e shkencës-teknologjisë-inxhinierisë-matematikës (STEM) në Kosovë. Ky studim çon më tutje debatin për rolin dhe pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe nevojën për të adresuar stereotipet për aftësinë e grave në këto fusha dhe për të nxitur kështu procesin efektiv për ndryshim.

## A E KENI DITUR...?

A

Çfarë mund të bëjë në Kosovë një turist? Një grup i operatorëve turistikë japonezë së pari testuan vetë opsionet para se të nisnin t'u rekomandojnë paketa të ndryshme klientëve në vendin e tyre. Histori e lashtë, monumente, qytete, ushqim, kulturë dhe trashëgimi fetare ishin temat që mbushën axhendën e tyre tre-ditore. Shpella e Gadimes, Kështjella e Novobërdës, parku arkeologjik i Ulpianës, një mbrëmje në Prishtinë, ndjekur nga atraksionet kryesore në Pejë, Rugovë, Gjakovë e plotësuan qëndrimin e tyre. Ky udhëtim familjarizues u organizua nga Ambasada e Kosovës në Japoni, me mbështetje nga Turkish Airlines dhe PPSE.

B

Filmat dhe dokumentarët janë pjesë e gjuhës universale të njerëzimit, që u flasin të gjithë audiencave. Gjatë edicionit 10 të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit PriFest, Kosova u transformua për pak në një pikëtakimi të regjisorëve, artistëve, shkrimtarëve dhe gazetarëve. Ne bashkuam forcat me PriFest për t'i dhënë këtij komuniteti të artistëve një mundësi ta shohin Kosovën përmes syrit të tyre profesional, si një destinacion i industrisë së filmit. Ne organizuam dy vizita një-ditore për të eksploruar peisazhet dhe lokacionet më pak të njohura të Kosovës që kanë potencial të shndërrohen në sheshxhirime për filma. PriFest gjithashtu organizoi një diskutim-forum "Kosovo Ready to Roll" për burimet njerëzore dhe kapacitetet teknike që Kosova mund t'u ofrojë produksioneve filmike ndërkombëtare.

C

Informacioni relevant, i besueshëm dhe i dobishëm është me rëndësi kyçe për rritjen e produktivitetit në nivel të fermave. PPSE ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti me Shoqatën e Tregtuesve të Inputeve Bujqësore (SHTIB) për të përmirësuar sistemin e ndarjes së informacionit dhe për t'u ndihmuar fermerëve të marrin vendime të mirëinformuara, të shfrytëzojnë mundësitë në treg dhe të menaxhojnë sistemin e prodhimit. Për të shtuar shërbimet për fermerë, SHTIB ishte në një vizitë dy-ditore në Shqipëri për të mësuar nga përvoja atje se si më mirë t'u shërbejnë fermerëve dhe të avokojnë në emër të sektorit.

D

Prezantimi i kulturave të reja është pjesë e zgjerimit të modelit të bujqësisë së kontraktuar. Sipas marrëveshjes së partneritetit që u nënshkrua, Agroshala-AG do të kontraktojë më shumë fermerë dhe do të kultivojë më shumë tokë me luledielli, farat e të cilave do të përpunohen në produkte të tjera për tregun e vendit dhe atë të eksportit, si për shembull: fara luledielli për konsumim dhe fara luledielli për sektorin e konditorisë. Në mënyrë që Agroshala-AG të rrisë kapacitetin e përpunimit dhe për rrjedhojë, të rrisë numrin e fermerëve të kontraktuar për kultivim, linja e re që do të sigurohet për pjekjen dhe zhveshjen e farave do të ketë rol të rëndësishëm.

# MODELI PËR NDRYSHIM

## Fokusi tek zhvillimi i biznesit nga brenda

Në jetën e çdo biznesi vjen një kohë kur ai ka nevojë të reflektojë, të riorganizohet dhe të fokusohet në pasqyrën më të madhe përpara vetes që të hedhë hapin e madh të radhës. “Këshillimi për biznes u ndihmon pronarëve dhe menaxherëve të ndërtojnë vizionin për rritje, të zhvillojnë strategjitë për rritje dheta rrisin performancën” thotë Kreshnik Lleshi nga CEED Kosova, organizata që i ka dhënë jetës idesë së programit “Coaching for Growth” (Këshillimi për Zhvillim).

“Këshillimi për Zhvillim” është program 9-mujor i projektuar specifikisht për kompani të përpunimit të ushqimit dhe konditorisë në Kosovë. Programi punon me pronarët dhe menaxherët nga ky sektor për të adresuar pengesat me të cilat ata përballen brenda kompanive dhe jashtë tyre. Këtu përfshihet gjithçka nga zgjerimi i linjave të prodhimit, përmirësimi i produkteve ekzistuese dhe zhvillimi i produkteve të reja, deri tek të kuptuarit e sjelljes së konsumatorit, promovimi i targetuar dhe përmirësimi i strategjive të tyre për marketing dhe shitje.



Qëllimi i menjëhershëm i programit mund të jetë të kuptuarit e pengesave për rritje, por aftësia për të parë drejt së ardhmes së biznesit dhe për të planifikuar përkatësisht është ajo çka programi synon në arrijë në afat të gjatë, për ta përsheptuar rritjen e bizneseve.

Të mësosh nga përvoja e kompanive që kanë qenë dikur në pozitë të ngjashme është mënyrë e dobishme për të parë në praktikë se si janë përballur ato kompani me sfidat që u janë paraqitur dhe si i kanë gjetur zgjidhjet. Për këtë qëllim, Programi “Këshillimi për Zhvillim” kishte si pjesë të vetën edhe vizita studimore tek kompani të përpunimit të ushqimit në vend dhe në rajon me përvojë në sektor.

Tek Vitaminka në Maqedoni, grupi u takua me menaxhmentin e lartë të kompanisë dhe mësuan direkt prej tyre rreth historisë së kompanisë, sfidave dhe rritjes së tyre ndër vite, e sidomos, si i zhvillojnë produktet e reja dhe si zgjerohen në tregje të reja. Po ashtu, grupi vizitoi edhe pjesën e prodhimit. Për Bujar Istrefin, menaxherin e përgjithshëm të “Missini”, vizita ofroi mundësi për



të mësuar rreth operacioneve të kompanicë, ndarjes së sektorëve dhe arranzhimeve për secilën linjë prodhimi. “Vizita më dha shtysën e duhur për të eksploruar mundësi që edhe ne të investojmë në makineri më të sofistikuar”, tha Istrefi.

Gjatë vizitës së dytë studimore tek Konex-Tiva Canning në Bullgari, pjesëmarrësit e programit mësuan për praktikën më të mirë që kompanitë bullgare të përpunimit të ushqimit kanë krijuar ndër vite. Tek Universiteti i Plovdivit për Teknologji Ushqimore, grupi mësoi për projektet hulumtuese në industrinë e përpunimit të ushqimit. “Kompanitë kosovare mund të eksplorojnë se çfarë ofron ky universitet sa i përket ngritjes së kapaciteteve për teknologë të ushqimit”, tha Lleshi.

Programi “Këshillimi për Zhvillim” implementohet nga CEED Kosovo dhe mbështetet nga projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat përmes aktiviteteve në sektorin e Ushqimit dhe Përbërësve Natyralë.



**“Këshillimi për biznes u ndihmon pronarëve dhe menaxherëve të ndërtojnë vizionin për rritje, të zhvillojnë strategjitë për rritje dhe t’i japin shtesë performancës”**

**Kreshnik Lleshi, CEED Kosovo**

Rr. Sylejman Vokshi Nr.42 |10000 Prishtinë, Kosovo  
Tel: +381(0)38220403  
email: ppseinfo@swisscontact.org  
website: www.ppse-kosovo.org and  
www.swisscontact.org/kosovo  
www.facebook.com/ppse.kosovo  
https://twitter.com/PPSE\_Kosovo

### Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat

Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.